BANKA E SHQIPERISE

KESHILLI MBIKQYRES

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR VEPRIMTARINË VALUTORE",

MIRATUAR ME VENDIM NR. 64, DATË 30.7.2003

TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në udhëzimin 1 të rregullores "Për veprimtarinë valutore", miratuar me vendim nr.64, datë 30.7.2003 të Këshillit Mbikëqyrës, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1.1 germa b ndryshohet si vijon: "fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës".

2. Pika 2.1 germa b ndryshohet si vijon: "fatura përkatëse e subjektit-ose një dokument, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës, dhe/ose kontrata dhe/ose marrëveshja përkatëse".

3. Pika 2.1 germa c shfuqizohet.

4. Pika 1.1 germa c1 ndryshohet si vijon: "në rastet e pagesës së pjesshme të shumës totale, në përputhje me kushtet e kontratës, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Me kalimin e këtij afati nuk do të kryhet pagesa e radhës për këtë mall deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit të paguar. Përjashtim bëjnë rastet kur afati i livrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por jo më shumë se 12 muaj."

5. Pika 1 "Transfertat për veprimet tregtare për mallrat" shtohet pika 1.5 me këtë përmbajtje: " 1.5 Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë për shumat deri në 3.5 milionë lekë ose ekuivalenten e saj në monedhë të huaj të llogaritur me kursin e ditës së kryerjes së pagesës:

a) Kërkesa për kryerjen e veprimit, ku jepet përshkrimi i natyrës dhe i qëllimit për të cilin kryhet, nënshkruar nga vetë kërkuesi. Po në këtë kërkesë, subjekti të deklarojë se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera.

b) Akti i zhdoganimit të mallit sipas rasteve të parashikuara në pikën 1.1. germa c.".

6. Këto ndryshime u miratuan me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI

Shkëlqim Cani